# DËSHMI ARKIVI

**A-442819**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | E fshehur brenda mishit të pulës, kapet 41 kg kokainë në Durrës - Euronews Albania |
| ADRESA | `https://euronews.al/e-maskuar-si-mish-pule-kapet-43-kg-kokaine-ne-durres/` |
| BURIMI | euronews.al |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 11:02:41 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 14 shtator 2026, 11:01:34 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `18775f98ffcf348c91d77b34048177e0b0d6f72f33c066092da2e85f67ca3e71` |
| TEKSTI | `70283d4907e187e610f3bb73bc96330963cd1a93d634d448df942b31066b0f74` |
| PAMJA | `34626d040898896677a23274c4962289a49257d132dfe81c64286b12db78fccd` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `7753644aae59bee73187bb9cbb92d261e7eb1289cf8e9d866bd969aa29c57087` |
| E MËPARSHMJA | `958c293be9a0b307f04ade1ba1d61337d0572ad870f2c552c6ac603f7544e675` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/7753644aae59bee73187bb9cbb92d261e7eb1289cf8e9d866bd969aa29c57087`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET | LAJM KRYESOR

# E fshehur brenda mishit të pulës, kapet 41 kg kokainë në Durrës

14 Shtator 2026 | 13:01

SHPËRNDAJE ARTIKULLIN

Një tjetër tentativë për të futur kokainë në Shqipëri përmes Portit të Durrësit është goditur nga Policia. Brenda një muaji, autoritetet kanë zbuluar tre raste të tentativës për trafikimin e lëndëve narkotike përmes portit.

Në kuadër të operacionit të koduar "Anchor 3", Policia ka sekuestruar 41 kilogramë e 350 gramë kokainë, me një vlerë të përllogaritur në treg prej rreth 2 milionë eurosh.

Operacioni u zhvillua nga Sektori për Hetimin e Narkotikëve në Durrës, në bashkëpunim me Drejtorinë Vendore për Kufirin dhe Migracionin dhe strukturat doganore të Portit të Durrësit, gjatë hetimeve për një rast të dyshuar trafikimi të lëndëve narkotike.

Sipas Policisë, droga u zbulua gjatë kontrollit të imtësishëm të një kontejneri me origjinë nga Brazili, i cili, bazuar në dokumentacionin shoqërues, deklarohej se transportonte mish pule.

Kontrolli zbuloi 37 paketime me lëndë të dyshuar si kokainë, të fshehura në kapakët e jashtëm të kontejnerit. Sasia totale e sekuestruar ishte 41.35 kilogramë.

Ndërkohë, hetimet vijojnë për të zbardhur të gjithë skemën, përfshirë origjinën dhe destinacionin e drogës, si dhe për identifikimin dhe kapjen e personave të përfshirë në këtë veprimtari kriminale.

Materialet procedurale i janë referuar Prokurorisë për veprime të mëtejshme.

**Shiko në:**

## LAJMI I FUNDIT

13:55 **Aksident gjatë stërvitjes ushtarake në Emiratet e Bashkuara Arabe, humbin jetën dy ushtarë**

13:43 **Ministri gjerman: Sulmi me dron në tren është përshkallëzim i llogaritur nga Putini**

13:38 **Tre të vdekur dhe 7 të plagosur nga një sulm rus në një depo në veri të Ukrainës (VIDEO)**

13:35 **"Liri për çlirimtarët", nesër marshim në Shkup në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së**

13:31 **Filmi "NAZA" merr çmim në Venecia, regjisorëve izraelitë u kërcënohet shtetësia nga qeveria pas dokumentarit për Gazën**

13:28 **Polonia gjen një dron të dyshuar rus në det pranë bregdetit Baltik**

## LAJME TË SUGJERUARA

AKTUALITET | LAJM KRYESOR | VENDI

**Berisha pas kthimit nga SHBA: Morëm pjesë në**

TESTIM

**vizitën e para 35 viteve**

Kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha këtë të hënë ka zhvilluar një konferencë për mediat teksa ka folur lidhur me vizitën e tij disa ditore...

12:43 | 14/09/2026

AKTUALITET | VENDI

### Aksident fatal në aksin Bradashesh-Peqin! Makina përplas të moshuarin që lëvizte me biçikletë, ndërron jetë 69-vjeçari

Një aksident i rëndë me pasojë vdekjen është regjistruar këtë të hënë në aksin Bradashesh-Peqin, pranë fshatit Bradashesh. Sipas raportimeve të policisë, ka humbur jetën...

12:03 | 14/09/2026

AKTUALITET | LAJM KRYESOR | VENDI

### Bllokuan bulevardet dhe akset kryesore gjatë protestës së djeshme në Tiranë, procedohen 20 persona

Janë proceduar këtë të hënë nga policia 20 pjesëmarrës, të cilët gjatë protestës së ditës së djeshme në Tiranë kanë bllokuar lëvizjen e automjeteve në...

11:34 | 14/09/2026



Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.